

DEPËRTIMI DHE PËRSHTATJA E HUAZIMEVE ANGLEZE NË GJUHËN SHQIPE

Kontaktet e niveleve të ndryshme të gjuhës shqipe me varietete po ashtu të ndryshme të gjuhës angleze janë më të hershme. Rugët e atyre kontakteve kanë qenë të ndryshme, në radhë të parë të natyrës kulturore, po edhe të drejtpërdrejta me rritjen e disporës shqiptare fillimisht në SHBA (qysh nga fillimi i sh XX) dhe pastaj në Britani e më vonë edhe në Australi e Zelandë të Re. Ndryshimet që ndodhën në dy dekadat e fundit në botënë përgjithësi dhe në botën shqiptare, proceset e globalizimit, pergjithesimi i komunikimeve elektronike, demokratizimi i shoqërisë shqiptare dhe proceset e integritit të saj në rrjedhat demokratike europiane, çlirimi dhe pavarësimi i Kosovës, prania protektorale e mekanizmave të Kombeve të Bashkuara dhendërkombëtare në përgjithësi në Kosovë pas Luftës së vitit 1999, hapja, normalizimi dhe intensifikimi i komunikimeve të botës shqiptare në Ballkan me diasporën, rritja e veprimtarive kulturore, proceset e integritimeve ekonomike, kanë krijuar një hapësirë shumë të gjerë të qarkullimit të dendur të fjalëve, të shprehjeve dhe të mënyrave të të folurit të gjuhës angleze dhe me to edhe të tjera ndërkombëtare në gjuhën shqipe në një shkallë që nuk e ka njohur më parë. Francezët, spanjollët, gjermanët e të tjerët, që kishin qenë në raporte intensive me botën britanike e tejoqanike, e kishin hetuar këtë prani dhe trysni mbi gjuhët e tyre më herët. Për të shënuar proceset e tilla ishin krijuar madje edhe shprehje të veçanta si Franglais, Spanglish, Denglish, etj. Përdorimet e anglishtes në Kosovë në dy dekadat e fundit kanë qenë shumë të dendura: në sate të statusit të mekanizmave ndërkombëtarë politikë, ekonomike e ushtarakë të pranishëm dhe për shumëçka drejtues të rrjedhave zhvillimore në vend e në rajon, ashtu si dhe statusin e gjuhës edhe formalisht zyrtare në Kosovë në periudhën e UNMIK-ut, të gjuhës faktikisht zyrtare në vijim, të gjuhës së dokumentacionit që në shumë situata bëhet burimor në versionin anglisht, në përdorimet e shqipes në hapësirat administrative, politike, e me komunikimet elektronike edhe gjerësisht kulturore, prania dhe ndikimet e anglishtes në gjuhën shqipe janë bërë të kudondodhshme. Mungesa e mekanizmave të organizuar dhe efikasë për kontrollimin e tyre në raport me rrjedhat zhvillimore të shqipes në gjerësinë aktuale të përdorimit ndërkombëtar dhe të përbaljes me këto realitete jo vetëm në Kosovë ka bërë që këto ndikime shpesh të duken dhe të dalin përtej rrjedhave normale të ndikimit për pasojë kontaktesh. Në shumë aspekte këto rrjedha po reflektohen drejtpërsëdrejti në zhvillimet e shqipes standarde dhe tjetër në të gjitha përdorimet e saj, me pasoja tashmë të hetueshme. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK-ut dhe KNGJSH e kanë parë të nevojshme të nisin një diskutim me përfshirje më të gjerë profesionistësh dhe të interesuarish për aspektet më të ndryshme të kësaj sate dhe nëse do të jetë nevoja në forma të përsëritura të tryezave të specializuara shkencore.

Këshilli organizues:
Rexhep Ismajli
Idriz Ajeti
Besim Bokshi
Mehmet Halimi
Mehmet Kraja

Personi kontaktues: Hilmi Zogjani

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë



Organizon

Tryezën shkencore

DEPËRTIMI DHE PËRSHTATJA E HUAZIMEVE ANGLEZE NË GJUHËN SHQIPE

Të enjten, më 27 qershor 2013,
me fillim në orën 9:30,
në mjediset e Akademisë.



PROGRAMI

9:30

1. *Fjala e hapjes dhe komente hyrëse:*
Rexhep ISMAJLI, Prishtinë
2. Vesel NUHIU, Prishtinë
Veprimet për kontrollin e përshtatjeve të anglicizmave në gjuhën shqipe
3. Jani THOMAI, Tiranë
Anglicizmat në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe
4. Bardh RUGOVA, Prishtinë
Kriteret për përcaktimin e anglicizmave
5. Shykrane GËRMIZAJ, Prishtinë
Sfidat dhe rezultatet e kontakteve të shqipes me anglishten
6. Jashar KABASHI, Prishtinë
Depërtimi i tepruar dhe i panevojshëm i huazimeve angleze në gjuhën shqipe në rrafshin leksikor dhe përshtatja e tyre në gjuhën shqipe
7. Arta TOÇI, Tetovë
Anglicizmat në mediet elektronike në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni
8. Valter MEMISHA, Tiranë
Depërtimi i emërtimeve të shkurtuara në shqipe prej anglishtes

Pushim

9. Linditë SEJDIU-RUGOVA, Prishtinë
Përshtatja e trajtave foljore të anglishtes në gjuhën shqipe

10. Agron DURO, Tiranë
Për një fjalor të huazimeve të anglishtes në shqipe
11. Drita KADRIU, Prishtinë
Fjalët angleze në dokumentacionin e kurikulës së Kosovës
12. Nebi CAKA, Prishtinë
Anglicizmat në terminologjinë teknike
13. Irena Pata KAPO, Tiranë
Anglicizmat në shtypin shqiptar pas 1990, vërshimi dhe sjellja e tyre në kontekstin shqiptar dhe në kushtet e globalizmit
14. Muhamet HAMITI, Prishtinë
Venerime për anglicizmat në shqip
15. Shkumbin MUNISHI, Prishtinë
Ndikimi i anglishtes në terminologjinë ekonomike
16. Albana NDOJA, Tiranë
Sugjerime që lidhen me futjet e reja (të anglicizmave, por jo vetëm) në gjuhën shqipe
17. Dieter NEHRING, Berlin - Prishtinë
Komente për anglicizmat në gjuhën shqipe

Diskutime/Komente

17. *Fjala e mbylljes.*

Shënim

Leximi i kumtesës zgjat 10-12 minuta.
Pjesëmarrësit duhet të dorëzojnë një kopje të kumtesës në formë elektronike dhe një të printuar në sekretarinë e AShAK-ut.
Versioni për botim mund të jetë më i gjatë dhe duhet të dërgohet deri më 15 shtator 2013.